



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 110

29 gusht

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Akt normativ i KM nr. 4, datë 16.8.2012	Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre.....	6443
Vendim i KM nr. 524, datë 16.8.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar	6451
Vendim i KM nr. 542, datë 28.8.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Brendshme, për përballimin e situatës emergjente, të krijuar nga zjarret në vendin tonë.....	6459
Udhëzim i MTKRS nr. 1, datë 8.8.2012	Mbi procedurat që ndiqen për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor, kriteret e vlerësimit dhe dokumentacioni ligjor.....	6460

AKT NORMATIV
Nr. 4, datë 16.8.2012

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR THERJEN E KAFSHËVE DHE TREGTIMIN E MISHIT TË TYRE

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave,
duke e vlerësuar situatën e rëndë dhe emergjente që paraqitet në Republikën e Shqipërisë, për parandalimin e fenomenit të therjes dhe tregtimit të mishit jashtë kushteve normale që garantojnë higjienën, jetën e njeriut, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin publik;
duke e çmuar këtë situatë me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën dhe shëndetin e njeriut, si dhe faktin se sipas nenit 21 të Kushtetutës jeta e personit mbrohet me ligj;
duke mbajtur në konsideratë nevojën për efekte të menjëhershme për sigurinë e jetës së qytetarëve, si një fushë me ndjeshmëri të madhe publike, si dhe
duke vlerësuar se zgjidhja e situatës së krijuar është e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga Kuvendi, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara,

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij akti normativ është vendosja e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre, si dhe përcaktimin e procedurës për parandalimin e shkeljeve, monitorimin dhe marrjen e masave për zbatimin e këtyre rregullave.

2. Qëllimi i këtij akti normativ është mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të njeriut, si dhe mbrojtja e mjedisit.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky akt normativ i shtrin efektet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekte të këtij akti normativ janë të gjithë personat që kryejnë veprimtari të therjes së kafshëve dhe të tregtimit të mishit të tyre.

Neni 3
Përkufizime

Termt e përdorur në këtë ligj kanë të njëjtin kuptim me termt e përdorur në ligjin nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, dhe në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008 “Për ushqimin”.



KREU II THERJA E KAFSHËVE

Neni 4

Vendi për therjen e kafshëve

1. Çdo aktivitet ekonomik i therjes së kafshëve bëhet vetëm nga subjekte të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit “QKR”, sipas legjislacionit në fuqi dhe ushtrohet në mjedise të cilat plotësojnë kushtet e ndërtimit, planimetrisë, pajisjeve me bazë materiale, si dhe të higjienës e sigurisë, që përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin.

2. Ndalohet rreptësisht therja e kafshëve në sheshe, rrugë kombëtare apo lokale, si dhe në çdo ambient të hapur për publikun.

3. Mjediset, në të cilat ushtrohet aktiviteti i therjes së kafshëve, duhet të garantojnë përmbushjen e kërkesave për respektimin e kushteve higjienike, mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njeriut, si dhe mbrojtjen e mjedisit.

4. Hapja, kontrolli dhe ndalimi i ushtrimit të aktivitetit të therjes së kafshëve bëhen sipas rregullave të përcaktuara në këtë akt normativ, si dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Kontrolli i procesit të therjes së kafshëve

1. Inspektorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit “AKU” inspektojnë të gjitha mjediset, ku kryhet aktiviteti i therjes së kafshëve, duke kontrolluar posaçërisht nëse subjektet përmbushin kërkesat e nenit 4 të këtij akti normativ.

2. Nëse subjekti nuk përmbush kërkesat e parashikuara në nenin 4, inspektorët e AKU-së plotësojnë dokumentin e vlerësimit të mjediseve ku ushtrohet aktiviteti i therjes së kafshëve dhe marrin masa për ndërprerjen e aktivitetit, si dhe vendosjen e sanksioneve, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë akt normativ.

3. Inspektorët e AKU-së, të Agjencisë Rajonale të Mjedisit “ARM” apo inspektorët sanitarë shtetërorë, nëse konstatojnë kryerjen e aktivitetit në kundërshtim me parashikimet e nenit 4 të këtij akti, kryesisht ose mbi bazën e njoftimit të organeve të qeverisjes vendore, së bashku ose veç e veç, janë të detyruar të marrin të gjitha ose njëri nga masat e mëposhtme:

- a) Ndalimin e menjëhershëm të ushtrimit të aktivitetit;
- b) Konfiskimin e kafshës, produkteve, veglave të punës, si dhe të çdo materiali tjetër nga ana e inspektorëve të AKU-së, pavarësisht nëse ka përfunduar apo jo procesi i therjes;
- c) Vendosjen e sanksioneve administrative sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë akt normativ;
- ç) Kthimin e gjendjes së mjedisit në kushte normale.

Neni 6

Detyrat e organeve të njësisë të qeverisjes vendore

1. Organet e njësisë të qeverisjes vendore janë të detyruara të ushtrojnë kontroll në territorin në administrim të tyre për aktivitetin e therjes që kryhet nga subjekte të paregjistruara në kundërshtim me parashikimet e nenit 4 dhe, nëse konstatojnë therjen e kafshëve në mjedise të hapura për publikun dhe/ose jashtë mjediseve, të cilat përmbushin kushtet e nenit 4, njoftojnë menjëherë strukturat e përcaktuara në nenin 5 të këtij akti normativ. Strukturat e përcaktuara në nenin 5 të këtij akti normativ, veprojnë menjëherë me marrjen e njoftimit, pavarësisht nga forma e tij, duke marrë të gjitha masat sipas këtij akti normativ.

2. Në rast mosveprimi të strukturave të përcaktuara në nenin 5 të këtij akti normativ, organet e njësisë të qeverisjes vendore janë të detyruara të njoftojnë përkatësisht ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin, ministrin përgjegjës për mjedisin dhe ministrin përgjegjës për shëndetësinë.

3. Organet e njësisve të qeverisjes vendore, nën përgjegjësinë personale të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, marrin masat për prishjen e çdo ndërtimi ose strukture të paligjshme që shërben për therjen e kafshëve në ambiente të hapura për publikun, si dhe kthimin e mjedisit në gjendje të përshtatshme.

Neni 7

Procesi i therjes së kafshëve

1. Procesi i therjes së kafshëve kryhet vetëm nga subjekte dhe në mjedise që përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 4 dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes së veterinerit zyrtar të strukturës veterinare vendore, procedurë në të cilën përfshihet kontrolli klinik i kafshës, si dhe të gjithë dokumentacionit shoqërues, përfshirë këtu certifikatën veterinare, lejen e lëvizjes dhe matrikullin. Therja e kafshës nuk kryhet deri sa kjo të lejohet nga veterineri zyrtar.

2. Në përfundim të procesit të therjes veterineri zyrtar i strukturës veterinare vendore kryen kontrollin e mishit, certifikimin e tij në përputhje me modelin e certifikatës shëndetësore veterinare, të miratuar nga ministri përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin, si dhe vulosjen e karkasës së kafshës, duke e cilësuar si të përshtatshme për konsum. Vulosja kryhet në sipërfaqen e jashtme të karkasës (shpatull, gjoks, kofshë) dhe vula duhet të ketë numrin e miratimit të subjektit, lëshuar nga AKU-ja.

3. Veterineri zyrtar e ofron këtë shërbim vetëm për kafshët që theren nga subjekte dhe në mjedise që përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 4 të këtij akti normativ.

4. Veterineri zyrtar siguron që vulosja e karkasës të bëhet vetëm për kafshët që i janë nënshtuar kontrollit para dhe pas therjes, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

5. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, nën përgjegjësinë e tij personale, mbikëqyr respektimin e këtij neni nga veterineri zyrtar që ushtron veprimtarinë në autoritetin e tij.

6. AKU-ja, nëpërmjet strukturave të tij rajonale, mbikëqyr respektimin e këtij neni nga strukturat përgjegjëse të pushtetit vendor. Nëse konstaton mosrespektim të kërkesave të këtij akti normativ apo të legjislacionit në fuqi njofton menjëherë prefektin dhe ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin, i cili vepron në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë akt normativ.

Neni 8

Trajtimi i karkasës pas përfundimit të procesit të therjes

1. Karkasat nuk duhet të jenë në kontakt me dyshe-menë, muret ose banakët e punës. Pas përfundimit të therjes, kontrollit *post-mortem* dhe certifikimit të tij, mishi ruhet në përputhje me kërkesat e parashikuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin.

2. Transporti i karkasës ose i pjesëve të saj drejt pikave të tregtimit bëhet me mjete të përshtatshme, në përputhje me kërkesat për higjienën dhe sigurinë ushqimore, të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin.

3. Mbikëqyrja e kërkesave të këtij neni bëhet nga AKU-ja nëpërmjet strukturave të tij në nivel vendor.

KREU III

TREGTIMI I MISHIT

Neni 9

Vendi për tregtimin e mishit

1. Çdo aktivitet ekonomik i tregtimit të mishit dhe të nënprodukteve të tij bëhet vetëm nga subjekte të regjistruara në QKR sipas legjislacionit në fuqi dhe ushtrohet në mjedise të cilat plotësojnë kushtet e ndërtimit, planimetrisë, pajisjeve me bazë materiale, si dhe të higjienës e sigurisë, që përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin.



2. Ambientet e tregimit të mishit duhet të garantojnë kërkesat për respektimin e kushteve higjienike, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njeriut, si dhe mbrojtjen e mjedisit.

3. Ndalohet rreptësisht tregtimi i mishit në sheshe, rrugë kombëtare apo lokale, si dhe në çdo ambient të hapur.

4. Hapja, kontrolli dhe ndalimi i ushtrimit të aktivitetit të tregimit të mishit dhe nënprodukteve të tij bëhen sipas rregullave të përcaktuara në këtë akt normativ, si dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 10

Kontrolli i tregimit të mishit

1. Inspektorët e AKU-së, të ARM-së apo inspektorët sanitarë shtetërorë mbikëqyrin të gjitha vendet e tregimit të mishit, duke kontrolluar posaçërisht nëse subjektet janë të regjistruara dhe nëse vendet e tregimit të mishit garantojnë kërkesat për respektimin e kushteve higjienike, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njeriut, si dhe mbrojtjen e mjedisit.

2. Nëse subjekti nuk përmbush kërkesat sipas nenit 9 të këtij akti normativ, inspektorët e AKU-së plotësojnë procesverbalin e konstatimit dhe marrin masa për ndërprerjen e aktivitetit të tij dhe vendosjen e sanksioneve, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë akt normativ.

3. Inspektorët e AKU-së, të ARM-së apo inspektorët sanitarë shtetërorë, nëse konstatojnë kryerjen e aktivitetit në kundërshtim me parashikimet e nenit 4 të këtij akti normativ, kryesisht ose mbi bazën e njoftimit të organeve të qeverisjes vendore, së bashku ose veç e veç, janë të detyruar të marrin të gjitha ose njëri nga masat e mëposhtme:

- a) Ndalimin e menjëhershëm të ushtrimit të aktivitetit;
- b) Konfiskimin e produkteve, veglave të punës, si dhe të çdo materiali tjetër, nga ana e inspektorëve të AKU-së;
- c) Vendosjen e sanksioneve administrative sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë akt normativ;
- ç) Kthimin e gjendjes së mjedisit në kushte normale.

Neni 11

Detyrat e organeve të njësisë të qeverisjes vendore

1. Organet e njësisë të qeverisjes vendore janë të detyruara të ushtrojnë kontroll në territorin në administrim të tyre për aktivitetin e tregimit të mishit dhe nënprodukteve të tij nga subjekte të peregjistruara në kundërshtim me parashikimet e nenit 9 dhe nëse konstatojnë tregtimin në mjedise të hapura për publikun dhe/ose jashtë mjediseve, të cilat përmbushin kushtet e nenit 9, njoftojnë menjëherë strukturat e përcaktuara në nenin 10, të këtij akti normativ. Strukturat e përcaktuara në nenin 10 të këtij akti normativ, veprojnë menjëherë me marrjen e njoftimit, pavarësisht nga forma e tij, duke marrë të gjitha masat sipas këtij akti normativ.

2. Në rast mosveprimi të strukturave të përcaktuara në nenin 10 të këtij akti normativ, organet e njësisë të qeverisjes vendore janë të detyruara të njoftojnë përkatësisht ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin, ministrin përgjegjës për mjedisin dhe ministrin përgjegjës për shëndetësinë.

3. Organet e njësisë të qeverisjes vendore, nën përgjegjësinë personale të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, marrin masat për prishjen e çdo ndërtimi ose strukture të paligjshme që shërben për tregtimin e mishit në ambiente publike, si dhe kthimin e mjedisit në gjendje të përshtatshme.

KREU IV DETYRAT E STRUKTURAVE TË TJERA SHTETËRORE

Neni 12 Detyrat e Policisë së Shtetit

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit, në bazë të njoftimit verbal të strukturave përgjegjëse për zbatimin e këtij akti normativ, janë të detyruar të marrin menjëherë masat për mbështetjen e veprimtarisë së inspektorëve të AKU-së, të ARM-së apo të strukturave vendore të shëndetit publik, në kuadër të zbatimit të dispozitave të këtij akti normativ. Gjithsesi, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga njoftimi verbal, struktura përgjegjëse, e cila ka bërë njoftimin verbal, i dërgon Policisë së Shtetit edhe njoftimin me shkrim.

2. Drejtuesi i strukturës vendore të Policisë së Shtetit, nën përgjegjësinë e tij personale, merr masat që punonjës policie në numër të mjaftueshëm të mbështetin veprimtarinë inspektuese të strukturave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Në rast mosveprimi të strukturave të Policisë së Shtetit, titullari i AKU-së, i ARM-së apo i strukturave vendore të shëndetit publik njoftojnë menjëherë drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke vënë në dijeni edhe Ministrin e Brendshëm, ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe ushqimin, ministrin përgjegjës për mjedisin dhe ministrin përgjegjës për shëndetësinë.

4. Zbatimi i detyrimit nga Policia e Shtetit mbikëqyret edhe nga prefekti, i cili, në çdo rast, njofton Ministrin e Brendshëm për mënyrën e përmbushjes së detyrave nga Policia e Shtetit.

Neni 13 Detyrimi për regjistrim në QKR

1. Të gjitha subjektet, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e therjes së kafshëve, si dhe të tregtimit të mishit e të nënprodukteve të tij, duhet të regjistrohen në QKR, sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Individët, të cilët aplikojnë për regjistrim, si person fizik, duhet të paraqesin në QKR, së bashku me të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar për regjistrim, edhe miratimin e lëshuar nga AKU-ja për përmbushjen nga ana e tyre të kërkesave të parashikuara në nenet 4 e 9 të këtij akti normativ.

3. Në rast se në momentin e aplikimit për regjistrim sipas pikës 2 të këtij neni, nuk paraqitet edhe dokumenti i miratimit paraprak nga AKU-ja, atëherë QKR-ja e konsideron kërkesën për aplikim të pavlefshme dhe nuk procedon me procesin e aplikimit për regjistrim.

Neni 14 Detyrat e ministrive të linjës

1. Ministri përgjegjës për mjedisin, ministri përgjegjës për bujqësinë, ushqimin dhe mbrojtjen e konsumatorit, ministri përgjegjës për shëndetësinë, Ministri i Brendshëm mbikëqyrin zbatimin e këtij akti normativ nga strukturat në varësi administrative të tyre.

2. Ministrat përgjegjës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, shkëmbejnë informacion në mënyrë të vazhdueshme për situatën e ushtrimit të veprimtarisë së therjes së kafshëve dhe tregtimit të mishit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Në funksion të mbikëqyrjes së mënyrës së zbatimit të këtij akti normativ, ministrat përgjegjës mund të ngrënë grupe pune, të cilat kanë detyra të veçanta për kontrollin e strukturave vartëse, për përmbushjen me korrektësi të përgjegjësive të parashikuara në këtë akt normativ.



Neni 15 Prefekti

Përveç detyrave të tjera të parashikuara shprehimisht në këtë akt normativ, prefekti kryen edhe bashkërendimin e punës ndërmjet strukturave të ndryshme të ngarkuara me zbatimin e dispozitave të këtij akti, me qëllim garantimin e ushtrimit prej tyre të përgjegjësive brenda territorit në administrim të tij.

KREU V KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET PËR STRUKTURAT PËRGJEGJËSE

Neni 16 Kundërvajtjet administrative

1. Veprimet apo mosveprimet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, vlerësohen si kundërvajtje administrative dhe dënohen nga strukturat përgjegjëse të përcaktuara në pikën 3 të nenit 5 të këtij akti normativ, si më poshtë vijon:

a) Therja e kafshëve nga subjekte të peregjistruara dënohet me gjobë në masën 100 000-200 000 lekë dhe merret masa e ndalimit të menjëhershëm të ushtrimit të aktivitetit. Në këtë rast, inspektori njofton me shkrim për shkeljen e konstatuar edhe zyrën e taksave vendore në bashki ose komunë, si dhe drejtorinë rajonale të taksave;

b) Mosrespektimi i kushteve të ndërtimit, planimetrisë, pajisjes me bazë materiale, si dhe të higjienës dhe sigurisë dënohet me gjobë në masën 50 000-100 000 lekë;

c) Therja e kafshëve në sheshe, rrugë kombëtare apo lokale, si dhe në çdo ambient tjetër të hapur për publikun dënohet me gjobë në masën 150 000-250 000 lekë;

ç) Therja e kafshëve në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 7 të këtij akti normativ, dënohet me gjobë në masën 100 000-200 000 lekë;

d) Trajtimi i karkasës pas përfundimit të procesit të therjes në kundërshtim me rregullat e parashikuara në nenin 8 të këtij akti normativ, dënohet me gjobë në masën 100 000-200 000 lekë;

dh) Tregtimi i mishit nga subjekte të peregjistruara dënohet me gjobë në masën 100 000-200 000 lekë dhe merret masa e ndalimit të menjëhershëm të ushtrimit të aktivitetit. Në këtë rast, inspektori njofton me shkrim për shkeljen e konstatuar edhe zyrën e taksave vendore në bashki ose komunë, si dhe drejtorinë rajonale të taksave;

e) Mosplotësimi i kushteve të parashikuara në këtë akt normativ për vendet e tregtimit të mishit dënohet me gjobë në masën 50 000-100 000 lekë;

ë) Tregtimi i mishit në sheshe, rrugë kombëtare apo lokale, si dhe në çdo ambient tjetër të hapur për publikun dënohet me gjobë në masën 150 000-250 000 lekë.

Neni 17 Procedura e shqyrtimit të kundërvajtjes administrative dhe vendosjes së masave administrative

Për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative sipas këtij akti normativ, për procedurat dhe afatet e ankimit, si dhe procedurat për ekzekutimin e sanksioneve administrative zbatohen rregullat e parashikuara në ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 18 Ekzekutimi i vendimit për kundërvajtjen administrative

1. Vendimi për kundërvajtjen administrative përbën titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor ose/dhe organet e parashikuara në këtë akt normativ, sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

2. Kur gjoba dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendimin për kundërvajtjen administrative nuk paguhen ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundërvajtje administrative, qoftë edhe kur ajo ndodhet nën posedimin e personave të tretë, sipas rregullave të parashikuara në ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Neni 19

Konfiskimi i kafshëve, i produkteve dhe i mjeteve të punës

1. Subjektit i konfiskohen kafshët, produktet dhe mjetet e punës apo materiale të tjera nga AKU-ja, kur:

a) nuk përmbushen kushtet e ushtrimit të aktivitetit sipas pikave 4 e 9 të këtij akti normativ;
b) është vendosur ndalimi i ushtrimit të aktivitetit dhe/ose subjekti është i paregjistruar apo është dënuar me masë administrative sipas këtij akti normativ dhe ky subjekt vazhdon ushtrimin e veprimtarisë.

2. Kafshët, produktet dhe mjetet e punës apo materiale të tjera, të cilat gjenden nga AKU-ja në mjedise të padeklaruara, konfiskohen. Nëse është e pamundur që pronari të identifikohet, kjo e dhënë shënohet në aktin administrativ të konfiskimit.

3. Me kërkesën e subjektit ndaj të cilit është marrë masa e konfiskimit, kjo masë mund të zëvendësohet me pagesën e vlerës së tregut të objektit të masës. Për këtë procedurë mbahet një procesverbal.

Neni 20

Sanksionet për strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij akti normativ

1. Moszbatimi i detyrave të parashikuara në këtë akt normativ nga secili prej punonjësve të caktuar në strukturat përgjegjëse, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe sjell fillimin e ecurisë disiplinore për nëpunësin e ngarkuar dhe drejtuesin e strukturës përgjegjëse, në rast se ky i fundit nuk vepron për të siguruar zbatimin e aktit normativ.

2. Në rast se kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk zbaton detyrat e parashikuara apo strukturat vartëse që janë nën mbikëqyrjen e tij nuk zbatojnë përgjegjësitë e parashikuara në këtë akt normativ dhe nëse kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk merr masa për këtë qëllim, ky mosveprim konsiderohet shkelje e rëndë e ligjit, në kuptim të pikës 1 të nenit 115 të Kushtetutës, dhe Ministri i Brendshëm, pas njoftimit të strukturave përgjegjëse, fillon procedurën për shkarkimin e tij nga detyra.

Neni 21

Veprimet kundërshtuese të subjekteve

Në rastet kur subjektet kundërshtojnë veprimet e strukturave përgjegjëse për zbatimin e këtij akti normativ, vepohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, ndërsa për rastet kur veprimet e subjekteve përbëjnë vepër penale, materialet u referohen organeve të procedimit penal.

KREU VI

EFEKTET E MENJËHERSHME TË AKTIT

Neni 22

Zbatimi i menjëhershëm i aktit normativ

1. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij akti normativ, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, sigurojnë që në territorin e Republikës së Shqipërisë veprimtaria e therjes së kafshëve dhe tregtimit të mishit të kryhet në vendet e përcaktuara sipas këtij akti normativ.

2. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij akti normativ ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme për të verifikuar respektimin e rregullave dhe kushteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe në këtë akt normativ.



3. Në rast konstatimi të therjes së kafshëve dhe/ose tregtimit të mishit të tyre, në ambiente të hapura, strukturat përgjegjëse zbatojnë dispozitat e këtij akti normativ.

Neni 23

Ngritja e strukturave monitoruese

1. Për ushtrimin e kontrolleve të menjëhershme për therjen e kafshëve dhe transportin e tregtimit të mishit ngrihet Task-Forca, e cila do të organizohet në nivel qendror dhe vendor.

2. Në nivel qendror, Task-Forca drejtohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe ka për detyrë koordinimin ndërinstytucional ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse në të, në nivel qendror e vendor. Kjo Task-Forcë përbëhet nga:

- a) Zëvendësministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- b) Zëvendësministri i Shëndetësisë;
- c) Zëvendësministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- ç) Zëvendësministri i Brendshëm, përgjegjës për pushtetin vendor;
- d) Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- dh) Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit;
- e) Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

3. Në nivel vendor, Task-Forca drejtohet nga prefekti dhe ka për detyrë ushtrimin në terren të kontrolleve në zbatim të legjislacionit të posaçëm dhe të këtij akti normativ, si dhe monitorimin e punonjësve të ngarkuar me përgjegjësinë për zbatimin e këtij akti normativ. Kjo Task-Forcë ka në përbërje të saj:

- a) Drejtorin rajonal të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- b) Drejtorin e policisë së qarkut;
- c) Drejtorin rajonal të taksave;
- ç) Titullarin e Inspektoratit Sanitar Shtetëror (sipas rastit, në nivel të Autoritetit Shëndetësor Rajonal Tiranë, të Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë, të Drejtorisë së Shëndetit Publik);
- d) Drejtorin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
- dh) Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore.

4. Task-Forca, në nivel vendor, ushtron kontrolle të përditshme, duke ndaluar ushtrimin e aktiviteteve ekonomike për therjen e kafshëve e tregtimit të mishit të tyre, në kundërshtim me legjislacionin e posaçëm në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit publik, mbrojtjes së mjedisit, rregullimit të territorit, legjislacionit tatimor, rendit publik dhe këtij akti normativ.

5. Task-Forca, në nivel vendor, njofton për rezultatet e punës së saj, çdo javë kryetarin e task-forcës në nivel qendror. Kryetari i Task-Forcës në nivel qendror, pas analizimit të situatës në mbledhjet e organizuara me task-forcën, në nivel qendror, informon Këshillin e Ministrave për efektet e menjëhershme që ka sjellë ky akt normativ, si dhe udhëzon task-forcën, në nivel vendor, dhe strukturat përgjegjëse për veprimet e mëtejshme që duhet të ndërmerren.

6. Nëse konstatohet mosveprim i strukturave përgjegjëse brenda afatit të parashikuar, si dhe në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Task-Forca në nivel qendror, veprohet në përputhje me nenin 20 të këtij akti normativ.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24

Dispozitë transitore

1. Subjektet, që ushtrojnë aktivitetin e therjes së kafshëve dhe të tregtimit të mishit dhe nënprodukteve të tij, duhet të përmbushin kushtet për mjediset e therjes dhe tregtimit, sipas përcaktimeve të bëra në këtë akt normativ, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij. Pas kalimit të këtij

afati, këto subjekte janë objekt i sanksioneve administrative të parashikuara në këtë akt normativ. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij akti normativ ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme për të verifikuar respektimin e rregullave dhe kushteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

2. Ngarkohet QKR-ja për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e nenit 13 të këtij akti normativ.

3. Kryetarët e njësisve të qeverisjes vendore duhet të plotësojnë me specialistë veterinerë organikën e strukturave veterinarë vendore, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 524, datë 16.8.2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj” dhe të neneve 12 e 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Lidhja nr. 1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr. 2, që përmendet në shkronjën “a” të pikës 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Paragrafi i parë i pikës 4/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4/1. “Specialistët”, “përgjegjësit e sektorit” apo “drejtorët”, të cilët punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme diplomë universitare “Master i shkencave” apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, në masën:..”.

ç) Pas pikës 4/12 shtohet pika 4/13, me këtë përmbajtje:



“4/13. Në Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, nëpunësi në pozicionin “titullar i institucionit”, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa nëpunësit në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Inspektor”, në sektorët teknikë, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj.”.

d) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. përfitojnë një shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin nëpunësit në pozicionet:

- “Specialist arkivi” në Kryeministri, Presidencë, Kuvend, aparatet e ministrive të linjës, si dhe në pozicionet “përgjegjës sektori” dhe “specialist” në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave e drejtoritë rajonale/vendore të sistemit të arkivave të shtetit;

- “Përgjegjës sektori” dhe “laborant” në laboratorët e naftës e të gazit dhe laboratorët e lëkurë - tekstileve, si dhe “inspektor” të naftës dhe gazit në doganë, autobot, çisternë dhe depozitë tokësore, në Inspektoratin Qendror Teknik;

- “Nëpunësit” në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura dhe në Laboratorin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Kjo shtesë aplikohet në masën dhe sipas rregullave e kriterëve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës.”.

dh) Pika 6 riformulohet, si më poshtë vijon:

“6. Struktura dhe nivelet e pagave për zëvendësministrin, prefektin, nënprefektin, nëpunësit e kabineteve në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrive të linjës dhe prefekturë janë, si më poshtë vijon:

Zëvendësministër 140 000 lekë;

- Drejtori i kabinetit të Presidentit, të Kryeministrit, të Kryetarit të Kuvendit, të Prokurorit të Përgjithshëm, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe të Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-a;

- Këshilltari i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit, i Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, këshilltari për protokollin i Kryeministrit, këshilltari për protokollin i Presidentit, zëdhënësi i Presidentit, drejtori i kabinetit të zëvendëskryeministrit dhe të Avokatit të Popullit barazohen në pagë me zëvendësministrin;

- Këshilltari i Prokurorit të Përgjithshëm, i kryetarit të Gjykatës së Lartë, i Avokatit të Popullit, ndihmësi i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit dhe këshilltari i zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-b;

- Ndihmësi i zëvendëskryeministrit dhe i nënkryetarit të Kuvendit, drejtori i kabinetit të ministrit dhe drejtorët e kabineteve të titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 të këtij vendimi, barazohen me nëpunësin civil të kategorisë II-a;

- Këshilltari i ministrit, zëdhënësi i ministrit, këshilltarët dhe zëdhënësit e titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 të këtij vendimi, barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b;

- Ndihmësit ligjorë pranë prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme dhe ekspertët në Prokurorinë e Përgjithshme barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-a;

- Prefekti i qarkut Tiranë 118 000 lekë;

- Prefekti në qarqet e tjera 110 000 lekë;

- Nënprefekti në nënprefekturat Kavajë, Lushnjë dhe Sarandë 94 500 lekë;

- Nënprefekti në nënprefekturat Krujë, Pogradec, Librazhd, Tepelenë, Përmet, Mat, Pukë, Tropojë dhe Skrapar 87 500 lekë;

- Nënprefekti në nënprefekturat Malësi e Madhe, Bulqizë, Peqin, Gramsh, Devoll, Mallakastër, Has, Kuçovë, Mirditë, Delvinë, Kurbin dhe Kolonjë 83 000 lekë;

- Këshilltari i prefektit, Tiranë	66 000 lekë;
- Zëdhënësi i prefektit, Tiranë	56 000 lekë;
- Sekretari i Presidentit, i Kryeministrit, i Kryetarit të Kuvendit, i Kryetarit të Gjykatës së Lartë, i Prokurorit të Përgjithshëm, i zëvendëskryeministrit, i nënkryetarit të Kuvendit dhe Avokatit të Popullit	69 000 lekë;
- Sekretari i ministrit, sekretari i këshilltarit të Presidentit, sekretari në zyrën e Avokatit të Popullit, sekretari i titullarëve të institucioneve të tjera të pavarura, të përmendura në pikën 1/1 të këtij vendimi, sekretari i organit kolegjal drejtues, sekretari në Kryeministri, në aparatet e ministrive të linjës dhe në institucionet e pavarura, të përmendura në pikën 1/1 të këtij vendimi,	57 700 lekë.

Shtesa për vjetërsi në punë për të gjitha pozicionet “sekretar” jepet në masën 2% pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërbëdhjetë mijë) lekë në muaj.

Të drejtën për të pasur këshilltarë të jashtëm e kanë vetëm Kryeministri dhe zëvendëskryeministri. Pagesa e tyre mujore është deri në 40% të pagës mujore të këshilltarit të brendshëm. Masa e pagesës përcaktohet nga titullari i institucionit përkatës.”.

e) Lidhja nr. 5, që përmendet në pikën 8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ë) Lidhja nr. 5/2, që përmendet në pikën 9, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

f) Lidhja nr. 6/7, që përmendet në pikën 10/7, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

g) Lidhja nr. 6/8, që përmendet në pikën 10/8, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

gj) Lidhja nr. 6/9, që përmendet në pikën 10/9, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

h) Lidhja nr. 7/1 (pjesët I dhe II), që përmendet në pikën 11/1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

i) Në pikën 11/1, vlera 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë zëvendësohet me vlerën 14 000 (katërbëdhjetë mijë) lekë.

j) Lidhja nr. 7/4, që përmendet në pikën 11/4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

k) Në pikën 11/4, vlera 13 000 (trembëdhjetë mijë) lekë zëvendësohet me vlerën 14 000 (katërbëdhjetë mijë) lekë.

2. Paga e Presidentit të Republikës, deri në miratimin e ligjit të buxhetit për vitin 2013, të jetë 257 000 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë) lekë.

3. Efektet financiare të këtij vendimi, për vitin 2012, fillojnë nga data 15 korrik 2012 dhe përballohen nga fondet e parashikuara për politikën e rritjes së pagave, ndërsa fondet për shtesën për natyrë të veçantë pune për Njësinë e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit përballohen nga buxheti i vetë institucionit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



STRUKTURA E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË/NËPUNËSIT NË TË GJITHA
INSTITUCIONET PJESË E FUSHËS SË VEPRIMIT TË KËTIJ VENDIMI

Klasa	Kategoritë	PAGA MUJORE			
		Paga individuale (Paga bazë)			Shtesa e pozicionit
1	2	3	4	5	
		Paga e grupit (PG) lekë	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV), në përqindje	Shtesa për kualifikim (SHK) lekë	Shtesa për pozicion (SHP) lekë
I	I-a		2%		128.500
	I-b		2%		117.500
II	II-a		2%		107.300
	II-b		2%		90.200
III	III-a		2%	0	72.900
	III-a/1		2%	0	63.700
	III-b		2%	0	55.500
IV	IV-a		2%	0	44.300
	IV-b		2%	0	34.200
	IV-c		2%	0	26.000

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Master i Shkencave Master i Arteve Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	14 000 lekë
2	Master profesional Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	11 000 lekë
3	Bachelor Të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

Lidhja nr. 5

**KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT
“SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI” NË INSTITUCIONET QENDRORE TË
PËRCAKTUARA SIPAS PIKËS 1/2 TË KËTIJ VENDIMI**

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës paga e grupit
Titullar i institucionit	II-a	1
Zv/titullar i institucionit Drejtor drejtorie Anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik	II-b	1
Anëtar i organit drejtues	III-a	1
Përgjegjës Sektori Përgjegjës i Bibliotekës Shkencore në Akademinë e Shkencave	III-a/1	1
Përgjegjës Sektori	III-b	1
Inspektor Redaktor në Akademinë e Shkencave	III-b	1 ose 2
Asistent Seksioni në Akademinë e Shkencave Bibliograf në Akademinë e Shkencave	IV-a	1 ose 2 ose 3
Specialist	IV-a	1 ose 2 ose 3
	IV-b	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 5/2

NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT KËRKIMORË E SHKENCORË NË AKADEMINË E SHKENCAVE

	Emërtimi	Paga në lekë
1	Kryetar i Akademisë së Shkencave	174.760
2	Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave	140.000
3	Akademik	123.500
4	Akademik i Asociuar Profesor	108.000
5	Profesor i Asociuar	94.000

SHTESAT NË PËRQINDJE MBI PAGËN MUJORE PËR FUNKSIONE DREJTUESE, TË PUNONJËSVE SI MË SIPËR

Pozicioni	Shtesa në lekë
Kryetar Seksioni. Sekretar Shkencor i Seksionit	12 000



Lidhja nr. 6/7

KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE CIVILË PËR EMËRTESAT “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI” NË INSTITUTIN GJEOGRAFIK TË USHTRISË, NË SHTABIN E PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA, NË KOMANDËN DHE SHTABIN E KOMANDËS SË DOKTRINËS DHE STËRVITJES

Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit
Titullar i institucionit	II-a	1
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	1
Përgjegjës Departamenti në Institutin Gjeografik të Ushtrisë	III-a	1
Përgjegjës i auditimit të brendshëm	III-a/1	1
Përgjegjës/shef sektori Shef dege	III-b	1
Inspektor auditit	III-b	1 ose 2
Specialist në Shtabin e Përgjithshëm	IV-a	1 ose 2 ose 3
Specialist Mjek në strukturat e Forcave të Armatosura	IV-b	1 ose 2 ose 3

Lidhja nr. 6/8

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT DOGANOR

Klasifikimi doganor	Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës paga e grupit	Shtesa e Pozicionit	
				Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
	Titullar i Institucionit	II-a	1		20 000
	Zv/drejtor i përgjithshëm	II-b	1		15 000
A	Këshilltar. Drejtor drejtorie. Drejtor drejtorie rajonale. Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Kakavijë, Rinas	III-a	1		15 000
B	Përgjegjës/shef sektori. Kryetar dege doganore Fier, Kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës, Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë Thanë, Elbasan. Përgjegjës operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës	III-a/1	1		14 000
C1	Inspektor kontrolli i brendshëm. Përgjegjës turni. Përgjegjës zyre. Komandant grupi antikontrabandë. Specialist. Administrator rrjeti	III-b	1 ose 2		14 000
	Financier në degë doganore, Përkthyes, Koordinator në DOH, Specialist i marrëdhënieve ndërkombëtare	III-b	1 ose 2		11 000

C2	Doganier kontrolli dokumentar, fizik. Inspektor antikontrabandë. Asistent laborator. Llogaritar	IV-a	1 ose 2 ose 3		11 000
C3	Doganier pranues. Doganier peshoreje. Doganier pike kontrolli. Përpunues informacioni. Sekretar. Arkivist			36 000	6 000
D1	Magaziner. Furnitor. Operator. Shofer. Teknik			31 000	2 500
D2	Punëtor mirëmbajtës			Klasa IV (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës)	
D3	Punonjës pastrimi			Klasa I (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për pagat e puno njëseve mbështetës)	

Lidhja nr. 6/9

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË TATIMEVE

				PAGA MUJORE			
EMËRTIMI				PAGA INDIVIDUALE		SHITESA E POZICIONIT	
Kategoria e vendit të punës	Kategoria e pagës	Paga e grupit (PG)		Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
1	2	3	4	5	6	7	8
	II-a	1	Drejtor i Përgjithshëm	2%	0		20 000
	II-b	1	Zv/drejtor i përgjithshëm	2%	0		15 000
A	III-a	1	Drejtor Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme. Drejtor i drejtorisë rajonale	2%	0		15 000
B	III-a/1	1	Përgjegjës/shëf sektori në drejtorinë e përgjithshme. Drejtor drejtorie në drejtorinë rajonale	2%	0		14 000
C1	III-b	1 ose 2	Përgjegjës/shëf sektori/zyre në drejtorinë rajonale. Inspektor i parë. Inspektor i auditit të brendshëm. Përgjegjës sektori në drejtorinë mbështetëse në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor hetimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve	2%	0		12 000
		1 ose 2	Përgjegjës zyre në Task-Forcë				
C2	IV-a	1 ose 2 ose 3	Inspektor i dytë. Specialist në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor hetimi në drejtorinë e përgjithshme dhe në drejtorinë rajonale	2%	0		12 000



	IV-b	1 ose 2 ose 3	Specialist në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor hetimi/ specialist në drejtoritë rajonale	2%	0		10 000
C3	IV-c	1 ose 2 ose 3	Specialist	2%	0		5 000
D1	IV-b	1 ose 2 ose 3	Sekretar në drejtorinë e përgjithshme	2%	0		5 000
	IV-c	1 ose 2 ose 3	Sekretar në drejtoritë rajonale	2%	0		5 000
			Nëninspektor	1%	0	30 000	10 000

Lidhja nr. 7/1

NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË TEATRIN KOMBËTAR, TEATRIN KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR, NË DREJTORINË E TEATRIT TË FËMIJËVE NË QENDRËN KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË DHE TEATRIN KOMBËTAR TË KOMEDISË

I - Për Teatrin Kombëtar dhe Drejtorinë Artistike të Teatrit të Operës dhe Baletit në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent Regjisor Solist i parë Koncertmaester Baletmaester Aktor i parë	77.700 lekë
2	Solist II (spala sektori)	72.200 lekë
3	Asistent dirigjent Asistent regjisor Aktor i dytë	69.500 lekë
4	Orkestrant i kategorisë së parë	62.500 lekë
5	Korist i kategorisë së parë Balerin i kategorisë së parë Skenograf i kategorisë së parë	58.300 lekë
6	Aktor i tretë	57.000 lekë
7	Orkestrant i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Balerin i kategorisë së dytë Skenograf i kategorisë së dytë	48.200 lekë

II - Për Drejtorinë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Drejtorinë e Teatrit të Fëmijëve në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrin Kombëtar të Komedisë

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent Regjisor	69.500 lekë
2	Solist i parë Orkestrant i kategorisë së parë Aktor i parë Skenograf i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Valltar i kategorisë së parë	58.300 lekë
3	Solist i dytë Orkestrant i kategorisë së dytë Aktor i dytë Skenograf i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Valltar i kategorisë së dytë	48.200 lekë

Lidhja nr. 7/4

**NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË QENDRËN E KULTURËS,
MEDIAS DHE BOTIMEVE TË MBROJTJES**

Nr.	Pozicioni	Paga
1	Udhëheqës Artistik	77.700 lekë
2	Dirigjent Regjisor	69.500 lekë
3	Instrumentist Vokalist	58.300 lekë

VENDIM

Nr. 542, datë 28.8.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
BRENDSHME, PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS EMERGJENTE, TË KRIJUAR NGA
ZJARRET NË VENDIN TONË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi prej 200 000 (dyqind mijë) eurosh, e barabartë me kundërvleftën e saj në lekë, për përballimin e situatës emergjente, të krijuar nga zjarret në vendin tonë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

6459



UDHËZIM
Nr. 1, datë 8.8.2012

**MBI PROCEDURAT QË NDIQEN PËR SHPALLJEN E KONKURSEVE KOMBËTARE DHE
NDËRKOMBËTARE PËR REALIZIMIN E VEPRAVE MONUMENTALE TË ARTIT PAMOR,
KRITERET E VLERËSIMIT DHE DOKUMENTACIONI LIGJOR**

Në mbështetje të nenit 104/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, si dhe të pikës 8 të kreut II të vendimit nr. 510, datë 18.7.2012 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor”,

UDHËZOJ:

I. Rregulla të përgjithshme

1. Organet e qeverisjes qendrore dhe vendore (më poshtë institucioni porositës), pas miratimit nga ministri përgjegjës për artet i përjetësimit të një figure kombëtare, me fonde të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit kanë të drejtë të shpallin një konkurs kombëtar a ndërkombëtar për realizimin e veprave monumentale të artit pamor.

2. Artistët e interesuar që paraqesin ide, projekte, bocete dhe shoqëritë e interesuara që realizojnë monumente të artit pamor, përzgjidhen nëpërmjet konkurrimit publik nga institucioni që ka në dispozicion fondin.

II. Procedurat e konkurrimit publik kombëtar dhe ndërkombëtar për përzgjedhjen e bocetit dhe projektidesë.

1. Titullari i institucionit porositës fillon procedurat e konkursit me nxjerrjen e urdhrin, i cili përmban:

- a) objektin e konkursit;
- b) detyrën e projektimit;
- c) afatin e paraqitjes së projektidesë;
- d) mënyrën dhe kohën e publikimit të njoftimit të konkursit kombëtar a ndërkombëtar.

2. Publikimi i konkursit kombëtar a ndërkombëtar bëhet nga titullari i institucionit porositës, sipas përcaktimit të bërë në pikën 1 të kreut II të vendimit nr. 510, datë 18.7.2012 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor”.

3. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat përkatëse për:

a) institucionin porositës që zhvillon konkursin;

b) afatin e dorëzimit të bocetit, projektidesë, që mund të jetë nga 3 deri në 12 muaj nga data e shpalljes së konkursit, në varësi të llojit të veprës monumentale (monument, shtatore, skulptura apo buste);

c) datën, orën dhe vendin e dorëzimit të bucitit, projektidesë;

d) dokumentacionin që duhet të paraqesin artistët pjesëmarrës në konkurs;

e) datën, orën dhe vendin e mbledhjes së jurisë që do të shqyrtojë bocetin dhe projektidenë;

f) procedurat e tërheqjes së boceteve, projektideve jofituese.

4. Institucioni porositës vë në dispozicion të konkurruesve dokumentacionin teknik dhe ligjor, i cili përmban:

a) përmasat e monumentit, shtatores, skulpturës apo bustit;

b) llojin e materialit që parashikohet të përdoret;

c) maketin dhe materialet shoqëruese;

d) bocetin dhe materialet shoqëruese;

e) listën e dokumentacionit që përmban CV-në e artistit, si dhe foto profesionale të punimeve të ngjashme.

5. Procedura e konkursit zhvillohet kur në datën dhe orën e njoftimit publik janë paraqitur të paktën 3 projektide. Në të kundërt, kjo procedurë anulohet dhe fillon një procedurë e re.

6. Pas dorëzimit të veprave, boceteve, projektideve, nga ana e artistëve, titullari i institucionit porositës, brenda 5 ditëve pune, ngre jurinë për vlerësimin e veprës, boceteve dhe projektidesë më të mirë, e cila në përbërje të saj ka jo më pak se 3 dhe jo më shumë se 9 anëtarë.

7. Anëtarët e jurisë nuk duhet të kenë konflikt interesi me pjesëmarrësit në konkurs, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9376, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

8. Juria do të vlerësojë bocetin, projektidenë bazuar në cilësinë artistike të veprës.

9. Afati për vlerësimin e boceteve, projektidesë, bëhet brenda jo më pak se 2 ditëve dhe jo më shumë se brenda 5 ditëve pune.

10. Brenda këtij afati kohor juria merr vendim për:

a) fituesin e konkursit;

b) përzgjedhjen e artistëve më të mirë konkurrues me një renditje nga 1 (niveli më i mirë) në 3 (niveli më i ulët);

c) vendimi i jurisë merret me shumicë të thjeshtë votash ose me sistem pikësh. Kur përdoret sistemi i pikëve, secili anëtar i jurisë ka në dispozicion nga 1 deri në 5 pikë për të vlerësuar secilin artist pjesëmarrës (1 vlerësim minimal, ndërsa 5 vlerësim maksimal).

11. Juria merr vendim edhe për shtyrjen e afatit të konkursit, nëse gjykon se koha e lënë në dispozicion për paraqitjen e boceteve, projektideve, ka qenë e pamjaftueshme.

12. Nëse juria e ka të pamundur të marrë një vendim për të shpallur një fitues, pasi ka dyshime në cilësinë artistike të veprës, ajo i propozon titullarit përsëritjen e procedurave të konkursit. Titullari i institucionit porositës miraton ose jo procedurat e ndjekura nga juria, si dhe vendimmarrjen e saj.

13. Nëse juria konstaton se ka shmangie nga detyra e projektimit, atëherë (ajo), juria mund të përzgjedhë jo më pak se 1 ose jo më shumë se 5 artistë nga artistët pjesëmarrës në konkurrim, vepra e të cilëve përbush më mirë disa prej elementeve të detyrës së projektimit, si dhe i përafrohet cilësisë artistike të kërkuar, për një fazë të dytë.

14. Juria përcakton afate të reja kohore për artistët e përzgjedhur për fazën e dytë. Përgjatë kësaj faze të dytë, juria duhet t’u paraqesë me shkrim artistëve ndryshimet, vërejtjet, si dhe kërkesat e saj, të cilat duhet të reflektohen nga artistët në fazën e dytë dhe finale.

15. Vendimi i jurisë i njoftohet titullarit të institucionit porositës. Vendimi i jurisë, si dhe miratimi ose jo i vendimit nga titullari i institucionit porositës nuk ankimohen.

16. Titullari i institucionit porositës shpall fituesin e bocetit apo projektidesë në web-site-n e institucionit, si dhe njofton me shkrim fituesin.

17. Titullari i institucionit porositës nënshkruan kontratën e porosisë me artistin fitues, e cila përmban:

a) projektin e detajuar të realizimit të veprës, përshkrimin e detajuar të fazave të realizimit të veprës;

b) planin kohor të realizimit të veprës;

c) detyrimin e artistit për ndjekjen e të gjitha fazave për prodhimin fizik të veprës deri në vendosjen e saj në sheshin e miratuar për këtë qëllim (përveç rastit kur artisti e prodhon vetë veprën).

III. Procedurat që do të ndiqen për realizimin e veprës monumentale

1. Titullari i institucionit porositës nxjerr urdhrin e zhvillimit të konkursit për realizimin e veprës monumentale, i cili përmban:

a) objektin e konkursit;

b) fondin e vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, nëse kjo është e mundur që në fillim;

c) komisionin e vlerësimit të ofertave.

2. Titullari i institucionit porositës bën ftesën për ofertë për realizimin e veprës monumentale të artit pamor. Ftesa përmban:

a) institucionin porositës të veprës monumentale të artit pamor;

b) projektin e detajuar të veprës;



- c) afatet e realizimit të veprës;
- d) listën e dokumenteve administrative dhe ligjore që duhet të paraqesë ofertuesi;
- e) datën, orën dhe vendin e paraqitjes së ofertave.

3. Dokumentacioni që dorëzohet në institucionin që ka bërë ftesën, duhet të përmbajë:

- a) çmimin e ofruar;
- b) grafikun kohor të realizimit të veprës;
- c) referenca për punime të ngjashme;
- d) kapacitetet teknike (makineri, hapësirë pune dhe burime njerëzore);
- e) sigurimin e subjektit (për subjektet ndërkombëtare);
- f) licencën e ushtrimit të veprimtarisë;

g) dokumentacionin fiskal (NUIS) (numri unik i identifikimit të subjektit) për subjektet kombëtare;

h) certifikatën e punimeve në metal (vetëm për subjektet ndërkombëtare);

i) certifikatën përkatëse të garancisë së standardit ndërkombëtar ISO (vetëm për subjektet ndërkombëtare).

4. Shqyrtimi i dokumentacionit të subjekteve konkurruese bëhet nga komisioni i vlerësimit, i cili në përbërje të tij ka specialistë të fushës, një ekonomist dhe një jurist. Afati i shqyrtimit dhe shpallja e subjektit fitues nga komisioni bëhet brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të ofertave.

5. Vlerësimi maksimal është 10 pikë dhe kriteret e vlerësimit të ofertave janë:

- a) referenca të ngjashme, 2 pikë;
- b) kapacitetet teknike që përfshijnë teknologji, hapësirën dhe burimet njerëzore, 2 pikë;
- c) çmimi i ofruar, 2 pikë;
- d) grafiku ditor i realizimit të veprës, 4 pikë.

6. Anëtarët e komisionit të vlerësimit nuk duhet të kenë konflikt interesi me pjesëmarrësit në konkurs, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9376, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

7. Procedura e konkurrimit zhvillohet në datën dhe orën e përcaktuar në ftesën për ofertë kur paraqiten jo më pak se tri oferta.

8. Nëse në datën dhe orën e caktuar nuk paraqiten tri oferta, komisioni vendos refuzimin e ofertave dhe i propozon titullarit të institucionit porosites përsëritjen e procedurës për mungesë konkurrence. Nëse edhe pas ripërsëritjes së procedurave paraqiten më pak se tri oferta, atëherë titullari i institucionit porosites mund ta vazhdojë procedurën edhe me dy konkurrentë.

9. Pas shqyrtimit komisioni i vlerësimit shpall klasifikimin përfundimtar të ofertave të konkurrentëve dhe iu bën me dije konkurrentëve të drejtën e ankimit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të këtij klasifikimi te drejtuesi i institucionit që zhvillon procedurën e konkurrimit. Pas këtij afati, nuk pranohet asnjë ankim dhe komisioni i propozon titullarit të institucionit shpalljen e subjektit fitues. Në të kundërt veprohet sipas procedurave të përcaktuara në kreun IV të këtij udhëzimi.

10. Njoftimi i fituesit publikohet në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik, ku përcaktohen:

- a) emri i fituesit dhe adresa e tij;
- b) afati i lidhjes së kontratës.

IV. E drejta e ankimit administrativ

1. Çdo subjekt, pjesëmarrës në konkurs, ka të drejtën e ankimit administrativ të një veprimi ose mosveprimi nga institucioni, që ka zhvilluar procedurën e konkurrimit, të cilin subjekti pjesëmarrës e vlerëson shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe të këtij udhëzimi.

2. Paraqitja e ankesës te titullari i institucionit që ka zhvilluar konkursin, pezullon procedurat e konkurrimit publik, shpalljen e fituesit dhe lidhjes së kontratës deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

3. Pasi institucioni që ka zhvilluar konkursin, të ketë nënshkruar kontratën me ofertuesin fitues, asnjë ankesë ndaj një veprimi ose mosveprimi në procedurën që ka çuar në atë stad, nuk do të paraqitet për t’u shqyrtuar në rrugë administrative.

4. Ankesa me shkrim duhet t'i paraqitet drejtuesit të institucionit që ka zhvilluar konkursin, brenda 5 (pesë) ditësh pas datës së njoftimit të klasifikimit përfundimtar të ofertave të subjekteve pjesëmarrëse në konkurs.

5. Pas marrjes së ankimit, titullari i institucionit pezullon procedimet e mëtejshme deri në shqyrtimin e tij dhe në marrjen e vendimit. Vendimi i njoftohet subjektit ankimues dhe konkurrentëve pjesëmarrës, brenda 10 ditësh nga data e depozitimit të ankimit.

6. Pas shqyrtimit të ankimit, titullari i institucionit vendos:

a) rrëzimin e ankimit dhe vazhdimin e procedurave;

b) pranimin e ankimit dhe revokimin e pjesshëm, si dhe rifillimin e procedurave nga çasti i konstatimit të veprimit apo mosveprimit të kundërligjshëm.

7. Vendimi i titullarit të institucionit është përfundimtar dhe mund të ankimohet në organet gjyqësore brenda afatit të përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative.

V. Kontrata e porosisë

1. Lidhja dhe zbatimi i kontratës së porosisë bëhet nga institucioni, që ka në dispozicion fondin dhe që ka zhvilluar konkurrimin, jo më vonë se 10 ditë nga data e shpalljes së fituesit në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Mbikëqyrja e realizimit të veprës bëhet nga artisti që është shpallur fitues i projektit më të mirë.

VI. Dispozita të fundit

1. Ngarkohen institucionet qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Aldo Bumçi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 29.8.2012
Doli nga shtypi më 29.8.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 30 lekë